



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Numri i lëndës: 2018:065650
Datë: 23.11.2018
Numri i dokumentit: 00176012

P.nr.1003/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Edona Selimi, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh.K. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1675/2018, të datës 02.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 21.11.2018, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Sh.K., nga babai H. dhe nëna Q., e lindur B., i lindur me datë ..., në fshatin ..., Komuna e ..., ku edhe jeton, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 17.10.2018, rreth orës 14:30 h, në rrugën e Kamenicës në afërsi të Banjës së Dobërqanit, i pandehuri Sh.K. ka rrezikuar trafikun publik, duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që duke e drejtuar automjetin për pasagjer të markës “Opel Astra” me tabela të regjistrimit ..., ka vepruar në kundërshtim me nenin 68.1 pika 1.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugorë, në atë mënyrë që duke vozitur në rrugën e lartëcekur, saktësisht pasi kalon ndërmarrjen “Saba Komerc”, duke mos e përshtatur shpjetësinë me kushtet e rrugës fillon një tejkalim duke mos e marrë parasysh vijën e bardhë të plotë dhe rrugën me kthesa, humbë kontrollin me automjetin, del nga rruga në anën e majtë dhe me pjesën e përparme të veturës së tij godet kodrën në të majtë të tij dhe vazhdon për një distancë dhe pastaj me rrëshqitje kalon jashtë rrugës në anën e djathtë dhe ndalet përfundimisht, me ç’rast shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale në automjetin e tij dhe lëndime të lehta trupore pësojnë të dëmtuarit H.K. dhe Q.K. nga fshati ..., Komuna e ..., ndërsa lëndime të rënda trupore pëson F.K. nga fshati ..., Komuna e ..., të cilët si pasojë e lëndimeve të pësuar, detyrohen të kërkojnë ndihmë mjekësore

në Spitalin Regjional në Gjilan, sipas raporteve me nr. 25613, 25617, 25609 të datës 17.10.2018 si dhe nga Reparti i Ortopedisë i datës 29.10.2018.

-Me këtë ka kryer veprën penale, rrezimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 4,41,42,43,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit Sh.K. i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 2 (dy) viteve nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara F.K. nga fshati ..., Komuna e ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të kësaj gjykate si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

REFUZOHET propozimi i Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm lidhur me shqiptimin e dënimit plotësues-Ndalimin e drejtimit të automjetit.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 02.11.2018, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 1675/2018, kundër të pandehurit Sh.K. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Më datë 21.11.2018, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori shtetit, i pandehuri Sh.K. dhe të dëmtuarit H., Q. dhe F.K., në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktaktakuzës nga ana e prokurorit ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me çrast gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezent prokurori i shtetit, i pandehuri si dhe të dëmtuarit, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së.

Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri Sh.K., ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ka vlerësuar se të pandehurit duhet t'i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 2 viteve nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Gjyqtari me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njejtë është penduar dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale si dhe faktin se nga veprimet e tij e dëmtuara F.K. ka pësuar lëndime të rënda trupore.

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit duke i marr parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Vendimi për refuzimin e shqiptimit të dënimit plotësues

Sa i përket shqiptimit të dënimit plotësues gjyqtari i vetëm gjykues konsideroi se meqenëse i pandehuri është në lidhje familjare me të dëmtuarit H. dhe Q.K. të cilët i ka prind dhe të cilët janë të shtyrë në moshë, si dhe nevojën e tyre për përkujdesje të shtuar sidomos nga ana e të pandehurit i cili është edhe mbajtës i familjes dhe përkujdeset për prindërit e tij, shqiptimi i këtij dënimi do të mund të ndikonte negativisht sa i përket përkujdesjes ndaj prindërve të tij të cilët kanë nevojë për një gjë të tillë andaj duke marrë parasysh rrethanat e lartcekura gjyqtari i vetëm gjykues vendosi që një propozim të tillë ta refuzoj.

7. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për relizimin e kërkesës pasurore juridike, e udhëzoi në kontest civil vetëm të dëmtuarën F.K. nga fakti se në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 21.11.2018, të dëmtuarit H. dhe Q.K. nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk kanë paraqitur propozim për realizimin e kërkesë pasurore juridike ndërsa e dëmtuara F.K. nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale mirëpo ka parashtruar propozim për realizimin e kërkesë pasurore juridike.

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë t'i paguajë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzete euro), në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dspozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1003/2018, me datë 21.11.2018

Procesmbajtësja,
Edona Selimi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.